



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 202/3 Prot.

Tiranë më 11.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 07, datë 11.02.2019

PËR KONTROLLUESIN “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE
MATERIALE TË SHETITIT”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 34 datë 05.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”, me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është institucion qendror në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka për funksion administrimin e rezervave materiale të shtetit.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.
Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: “...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet

ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.dprms.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal, por ka publikuar një informacion të shkurtër mbi ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave. Informacioni i publikuar në *“Politikat e Privatësisë”*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika I: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*” dhe Vendimit nr. 6/20122 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime dhe deklaruan se do të merren masat për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi *“Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”* në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit *“Njoftimin”* në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
2. Kontrolluesi *“Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”* në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet *“Politikës së Privatësisë”* në portalin zyrtar <http://www.dprms.gov.al>.
3. Kontrolluesi *“Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit”*, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 15 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbyllja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 11.2.2019

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

